

<b>Teoritë bashkëkohore të intervenimit në komunitet ( 2+1 /6 ECTS, O)</b>	
<b>Të dhëna bazike të lëndës</b>	
<b>Njësia akademike:</b>	<b>Fakulteti filozofik</b>
<b>Titulli i lëndës:</b>	<b>Metodat e hulumtimit të avancuar</b>
<b>Niveli:</b>	<b>Master</b>
<b>Statusi lëndës:</b>	<b>Obligative</b>
<b>Viti i studimeve:</b>	<b>I</b>
<b>Numri i orëve në javë:</b>	<b>2+1</b>
<b>Vlera në kredi – ECTS:</b>	<b>6</b>
<b>Koha / lokacioni:</b>	<b>Mërkure 15:00:16:30 Salla 101</b>
<b>Mësimdhënësi i lëndës:</b>	<b>Prof. ass dr. Mytaher Haskuka Ass. MA. Ereblir Kadriu (PhD kandidat)</b>
<b>Detajet kontaktuese:</b>	<a href="mailto:mytaher.haskuka@uni-pr.edu">mytaher.haskuka@uni-pr.edu</a> <a href="mailto:ereblir.kadriu@uni-pr.edu">ereblir.kadriu@uni-pr.edu</a>
<b>Përshkrimi i lëndës</b>	Kjo lëndë mbulon çështjet të rëndësishme të hulumtimeve shkencore. Përmbajtja e lëndës në fjalë konsiston në diskutimin e gjithë hapave të një hulumtimi, duke përfshirë si modelin kuantitativ ashtu edhe atë kualitativ. Përkitazi me modelet dhe dizajnet hulumtuese, teknikat statistikore do të jenë të prezantuara po ashtu. Specifikisht kjo lëndë ofron një përmbledhje të metodave të hulumtimit me vëzhgim, metodat korrelacionale, anketim, studim të rastit, eksperiment, kuazi-eksperiment dhe vlerësim të programeve. Theksi i kushtohet modeleve eksperimentale, kuazi-eksperimentale dhe korrelative, si dhe metodave të mbledhjes, analizimit dhe interpretimit të të dhënave psikologjike. Tema të tjera përfshijnë vlefshmërinë, besueshmërinë, shkrimin e propozimeve dhe raporteve kërkimore, dhe etikën në hulumtim. Studentët do të lexojnë artikuj kërkimorë nga revista shkencore dhe njihen me procedura statistikore më të avancuara.
<b>Qëllimet e lëndës:</b>	Të aftësojë studentët mbi metodat e hulumtimit, të gjithë hapat e realizimit të një hulumtimi shkencor, si dhe implementimin e një hulumtimi shkencor dhe shkrimin e raportit shkencor.
<b>Rezultatet e pritura të nxënies:</b>	Studentët do të kenë aftësi në metodat e hulumtimit dhe shkrimin e punimeve shkencore.

	Studentët do të jenë në gjendje të identifikojnë, diskutojnë, t'i zbatojnë metodat e duhura të hulumtimit për çështje të ndryshme që lidhen me psikologjinë klinike dhe komunitare.		
<b>Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondojë me rezultatet e të nxënit të studentit)</b>			
<b>Aktiviteti</b>	<b>Orë</b>	<b>Ditë/javë</b>	<b>Gjithësej</b>
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	1	15	15
Punë praktike	2	10	10
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	2	2	4
Ushtrime në teren	2	1	6
Kollokfiime,seminare	1	2	5
Detyra të shtëpisë	1	5	10
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	2	15	30
Përgaditja përfundimtare për provim	5	3	10
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)	2	2	5
Projektet,prezentimet ,etj	3	9	25
<b>Totali</b>			<b>150</b>
<b>Metodologjia e mësimdhënies:</b>	Ligjëratat do të ofrojnë informata mbi metodat e ndryshme të hulumtimit të kombinuara me artikuj që ilustrojnë metodologjitë e përshkruara. Fokusi do të jetë në qasjen kolaborative të mësuarit dhe ligjërimit dhe pjesëmarrësit janë të inkurajuar të marrin pjesë aktive në aktivitete të ndryshme si: prezantime; ushtrime; diskutime; debate dhe video- prezantime. Pjesëmarrësit janë të inkurajuar të reflektojnë mbi përmbajtjen e lëndës dhe të diskutojnë se si qasjet kryesore teorike reflektohen në punën e tyre praktike.		
<b>Metodat e vlerësimit:</b>	Pjesëmarrja aktive dhe realizimi i detyrave të lëndës ( 10 %)		

	<p>Punimi semstral (30%)</p> <p>Prezantimi i punimit (10%)</p> <p>Provimi final ( 50 %)</p> <p>Kriteret e kalueshmërisë:</p> <p>60-66%- 6; 67-76%- 7; 77-85%- 8; 86-92%-9; &lt;92%- 10</p>
<b>Literatura</b>	
<b>Literatura bazë:</b>	<p>Mark L. Mitchell, Janina M. Jolley - Research Design Explained, 7th Edition -Wadsworth Publishing (2010)</p> <p>David Giles (2002). Advanced Research Methods in Psychology</p> <p>John E. Edlund (Editor) and Austin Lee Nichol (2019). Advanced Research Methods for the Social and Behavioral Sciences</p> <p>Creswell, J. (2013). Research design – qualitative, quantitative, and mixed methods approach.</p>
<b>Literatura shtesë:</b>	<p>Howitt, D and Cramer, D. (2008). Introduction to research methods in psychology</p> <p>Mertens, D.(2009). Research and Evaluation in Education and Psychology: Integrating Diversity with Quantitative, Qualitative and Mixed Methods. ISBN-13: 978-1412971904</p> <p>Matthews, B and Ross, L (2010). RESEARCH METHODS: A practical guide for the social sciences.</p> <p>Artikuj nga revistave shkencore, të ndërlidhura me temat javore</p>

<b>Plani i detajizuar i punës për një semestër</b>	
<b>Javët</b>	<b>Temat</b>
<b>Java 1</b>	Hyrje në hulumtimin shkencor; karakteristikat e mendimit dhe qasjes ndaj dijes në shkencë
<b>Java 2;</b>	Teoria, hulumtimi dhe aplikimi i shkencës
<b>Java 3;</b>	Etika në hulumtimin shkencor
<b>Java 4;</b>	Shqyrtimi i literaturës, përcaktimi i problemit dhe formulimi i pyetjeve hulumtuese
<b>Java 5;</b>	Zhvillimi i Strategjisë për matje: Operacionalizimi, validiteti dhe besueshmëria e matjeve
<b>Java 6;</b>	Metodat e hulumtimit kuantitativ deskriptive
<b>Java 7;</b>	Metodat e hulumtimit kuantitativ korelacional

<b>Java 8;</b>	Metodat e hulumtimit eksperimental
<b>Java 9;</b>	Çështje ne dizajnim të hulumtimeve dhe statistikë 1
<b>Java 10;</b>	Çështje ne dizajnim të hulumtimeve dhe statistikë 2
<b>Java 11;</b>	Hulumtimet kualitative
<b>Java 12;</b>	Çështje ne dizajnim të hulumtimeve dhe përpunim të të dhënave kualitative
<b>Java 13;</b>	Metodat e kombinuara (mixed methods)
<b>Java 14;</b>	Vlerësimi i projekteve/ programeve
<b>Java 15;</b>	Shkrimi i propozimeve për hulumtim dhe raporteve shkencore
<b>Definimi i përbashkët i rregullave me studentët:</b>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Mësimdhënësi do të ndihmojë të nxënit e studentëve dhe arritjet e qëllimeve të lëndës përmes vlerësimit të progresit të studentëve në vazhdimësi dhe në një mënyrë që ju ofron atyre prapaveprim (feedback) të përdorshëm;</li> <li>- Studentët janë fuqimisht të inkurajuar që të bëjnë pyetje, të komentojnë dhe të marrin pjesë në diskutimet klasore;</li> <li>- Sjellja e duhur akademike është e domosdoshme. Kopjimi i punës së të tjerëve, përdorimi i materialeve të pa-aprovuara gjatë provimeve dhe kuizeve, apo marrja (duplikimi) e/i punës së tjetrit paraqet mashtrim dhe nuk do të tolerohet;</li> <li>- Përdorimi i lap-topëve (kompjuterëve) lejohet vetëm me aprovimin paraprak të mësimdhënësit;</li> <li>- Përdorimi i telefonave mobil nuk është i lejuar;</li> </ul>	